



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 23/2015

Prishtinë, më 30.6.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, dhe Duda Balje, anëtarë. Nga Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, mori pjesë deputetja Shqipe Pantina.

Munguan: Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha - OSBE; Syzana Bytyçi- BE; Visar Berisha – INDEP, Visar Hoti - AMPEK/TV TEMA, Enver Basha dhe Marcelë Ponosheci – MZHE, Liridon Dalipi- KPM, Besa Berisha dhe Arta Xhylani – UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9.6.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit me Amendamente i Projektligjit Nr.05/L-27 për digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore;
4. Themelimi i grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizim;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9.6.2015;

Procesverbal i mbledhjes së mbajtur më 9.6.2015 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Amendamente i Projektligjit Nr.05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuze tokësore;

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha se grupi i punës për shqyrtimin e projektligjit për digjitalizimin e transmetimeve radio difuze tokësore ka shqyrtuar projektligjin dhe sot në këtë mbledhje z. Raif Qela, kryesues i grupit të punës e paraqet raportin me amendamente.

Raif Qela i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me aktivitetet e realizuara gjatë shqyrtimit të projektligjit. Për këtë projektligj, shtoi ai, është mbajtur një punëtori në Durrës, ku kanë marrë pjesë përveç grupit të punës edhe përfaqësues të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Komisionit të Pavarur të Mediave, Autoritetit Rregullativ për komunikime elektronike dhe postare, përfaqësues të industrisë së mediave të Kosovës. Në vazhdim z.Qela paraqiti propozim amendamentet e grupit të punës.

Lidhur me nenin 1, janë dy propozim-amendamente; propozimi i parë është më i shkurtër, ndërsa propozimi i dytë është sikurse në projektligj, por vetëm është hequr referenca në Konkluzionet e Konferencës Rajonale Radio komunikuese dhe paraqet më qartë dhe sqaron përmbajtjen tërë projektligjit.

Pas diskutimeve propozimi i dytë u përkrah nga Komisioni, me tekstin si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 1 ndryshohet si ne vijim:

Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë procesin kalues nga transmetimi analog në atë digjital në Republikën e Kosovës, të përcaktojë kushtet për zbatimin e transmetimeve radio difuze tokësore digjitale, të përcaktojë të drejtat dhe obligimet e operatorëve të rrjetit, operatorëve të multipleksëve dhe ofruesve të shërbimeve mediale, ndryshimet në menaxhimin e brezit radio frekuencor brenda rangut të frekuencave 61-69 UHV (790-862 MHz), i cili do të lirohet për dividendin digjital, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin efikas të brezit radio frekuencor, i cili në pajtim me aktet juridike kombëtare (nacionale) dhe ndërkombëtare është i paraparë për transmetimin e programeve radio televizive.

Propozim amendament për riformulimin e nenit 2, dallimi qëndron se me këtë amendament është hequr një pjesë e tekstit në fund të nenit, i konsideruar si i panevojshëm.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni, me tekstin si në vijim:

Amendamenti 2

Neni 2 riformulohet si vijon:

Ky ligj rregullon metodën dhe kushtet për transmetimet radio difuze tokësore digjitale, procedurën për kalimin nga transmetimet radio difuze analoge në ato digjitale.

Për nënparagrafin 1.2 të nenit 3, propozim amendamenti përmirëson këtë paragraf në aspektin tekniko-gjuhësor.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni, me tekstin si në vijim:

Amendamenti 3

Neni 3 nënparagrafi 1.2., fjala “transferimit” zëvendësohet me “kalimit”; togfjalëshi “radio difuzive” bëhet fjalë e bashkëngjitur “radiodifuzive” dhe, kjo vlen për tërë projektligjin.

Lidhur me nënparagrafin 1.3 të nenit 3, kryesuesi i grupit të punës tha se është zhvilluar debat i gjerë gjatë punëtorisë, ku është kërkuar që kanaleve ekzistuese me transmetim analog të mos i referohemi si kanale historike televizive. Me propozim amendament, grupi i punës ka shmangur termin “historike”.

Komisioni përkrahi amendamentin me tekstin si në vijim:

Amendamenti 4

Neni 3 nënparagrafi 1.3 ndryshohet si në vijim:

1.3. Kanalet televizive të licencuara për transmetim analog tokësor, janë të gjitha subjektet e licencuara nga KPM-ja për transmetimin radiodifuziv analog në Republikën e Kosovës, qofshin ato me licenca për transmetim në tërë territorin apo me licenca për transmetim rajonal/lokal.

Amendamenti tjetër është përmirësim tekniko gjuhësor i nënpragrafit 1.5 të nenit 3.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni me tekstin në vijim:

Amendamenti 5

Neni 3 nënparagrafi 1.5, fshihet lidhëza “dhe” dhe fjala “gjithashtu”.

Shprehja “must carry”, e përdorur në nenin 19 të projektligjit, është shprehje që duhet të përkufizohet meqenëse është i paqartë kuptimi i saj.

Pas diskutimeve Komisioni përkrahi përkufizimin si vijon:

Amendamenti 6

Neni 3 pas nënpragrafit 1.7, shtohet një nënparagraf i ri si në vijim:

“Must carry” nënkupton bartje të detyrueshme.

Z.Qela propozoi që të ndryshohet përkufizimi për termin “Multipleks” nënparagrafi 1.7 i nenit 3, dhe të shtohet përkufizimi “Platformë multipleksi”, dhe shprehja “Operatori i multipleksit” të zëvendësohet me “Operator i platformës së multipleksit”.

Lidhur me përkufizimet e propozuara nga z.Qela, deputeti **Besim Beqaj** tha se nuk duhet të ndërhyjmë në përkufizime sepse mund t’i gjymtojmë, pasi që nuk kemi ekspertizën e nevojshme profesionale për me i përkufizuar këto shprehje teknike.

Pas shqyrtimit dhe diskutimeve, Komisioni nuk përkrahi ndryshimin e përkufizimit për termin “Multipleks”, po ashtu nuk përkrahi edhe ndryshimin për “Operatorin e multipleksit”, ndërsa përkrahi propozim amendamentin për përkufizimin e shprehjes “Platformë multipleksi”. Meqenëse nuk u përkrahen përkufizimet tjera, deputeti Qela hoqi dorë edhe nga amendamenti për përkufizimin e shprehjes “Platformë multipleksi”, sepse siç tha ai, si e vetme pa tërësinë kjo shprehje është e tepërt.

Lidhur me nenin 3, nënparagrafët 1.17 dhe 1.18, propozim amendamenti është që në vend të shprehjes “me definicion standard” përkatësisht “me definicion të lartë” të përdoret shprehja “me kualitet standard” përkatësisht “me kualitet të lartë”.

Komisioni përkrahu propozim amendamentin me tekstin në vijim:

Amendamenti 7

Neni 3 nënparagrafet 1.17 dhe 1.18., shprehja “Televizioni me definicion standard (SDTV)” zëvendësohet me “Televizioni me kualitet standard SDTV” dhe “Televizioni me definicion të lartë (HDTV)” zëvendësohet me “Televizioni me kualitet të lartë (HDTV)”, këto ndryshime vlejnë për tërë tekstin e projektligjit.

Për neni 4, paragrafi 4, ka një propozim amendament që shprehja “dhe Autoriteti” të zëvendësohet me “në bashkëpunim me Autoritetin”.

Komisioni përkrahu këtë propozim amendament me tekstin në vijim:

Amendamenti 8

Neni 4 paragrafi 4 fjala “dhe Autoriteti”, zëvendësohet me “në bashkëpunim me Autoritetin”.

Propozim amendamenti për nenin 5, ndryshon fjalët nga “emetim” në “transmetim”.

Po ashtu **kryetari Muhamet Mustafa** propozoi që edhe fjala “miratim” të zëvendësohet me fjalën “licencë”.

Propozimi u përkrah nga Komisioni, dhe teksti përfundimtar i riformuluar është si vijon:

Amendamenti 9

Neni 5 riformulohet si në vijim:

Të gjithë personat juridikë që janë pajisur me licencë për transmetim të programeve përmes rrjetit transmetues radiodifuziv tokësor digjital dhe me licencë për t’i shfrytëzuar frekuencat, në pajtim me Ligjin e Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Ligjin për komunikimet elektronike, kanë statusin e operatorit të rrjetit.

Lidhur me nenin 7, anëtarja e grupit të punës nga Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, **znj. Shqipe Pantina**, tha se ashtu si është në projektligj ku operatori i rrjetit mund të jetë edhe operator i multipleksit krijon monopol dhe nuk pajtohem me këtë nen, prandaj kërkoj që ai të ndryshohet.

Lidhur me këtë, **z. Qela** tha se nuk ka rrezik për monopolizim të skenës mediale nëse operatori i multipleksit është edhe operator i rrjetit, sepse operatori i rrjetit bën vetëm transmetim të sinjaleve apo të dhënave, pa marrë parasysh se çka përmbajnë ato të dhëna, pra është vetëm një transportues nga një vend në vendin tjetër. Më tutje z. Qela tha se rreziku për monopolizim të skenës mediale vjen nëse i mundësohet ofruesit të shërbimeve mediale të jetë edhe operator i multipleksit, sepse vetëm duke i pasur këto të dyja, ka rrezik që të përjashtojë nga pjesëmarrja në multipleks ofrues tjerë të shërbimeve mediale, apo të mos iu krijojë kushte për konkurrencë të barabartë, duke e konsideruar si rival në shërbimet mediale, por kjo ndodh vetëm në rast se Rregullatori nuk e kryen punën siç duhet.

Pas këtij komenti, kryetari i Komisionit, **z. Muhamet Mustafa** propozoi që të futet edhe një amendament me këtë përmbajtje, të cilën e tha këtu kryesuesi i grupit të punës, z. Qela.

Deputeti Qela propozoi amendamentin me tekstin si në vijim:

Amendament 10

Neni 7, pas paragrafit 3, shtohet një paragraf i ri si në vijim:

4. Përveç transmetuesit publik, asnjë ofrues tjetër i shërbimeve mediale nuk mund të jetë operator i multipleksit.

Komisioni përkrahu propozim amendamentin e deputetit Raif Qela.

Propozim amendamenti për nenin 8, paragrafi 3 ndryshon këtë paragraf, ku me amendament shtohet fjala “elektronike”.

Komisioni e përkrahu këtë propozim amendament me tekstin në vijim:

Amendamenti 11

Neni 8 paragrafi 3 ndryshohet si vijon:

3. Cilësia e shërbimeve elektronike që i referohet paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parametrat e cilësisë së shërbimeve të përcaktuara në Ligjin për Komunikimet Elektronike.

Për nenin 8, paragrafin 4, grupi i punës ka propozuar amendament, ku në vend të “Autoritetit” për sigurimin e cilësisë së shërbimeve, përgjegjësinë ia jep “KPM-ja”.

Ky propozim amendament nuk u përkrah nga Komisioni. Pas diskutimeve Komisioni vendosi që paragrafi 4 i nenit 8 të fshihet.

Amendamenti 12

Neni 8, paragrafi 4, fshihet.

Lidhur me paragrafin 1, të nenit 10, grupi i punës ka bërë propozim amendament, me të cilin hiqet shprehja “operatori i rrjetit” nga ky paragraf.

Komisioni përkrahu amendamentin me formulimin si në vijim:

Amendamenti 13

Neni 10. paragrafi 1., ndryshohet si në vijim:

1. Multipleksi menaxhohet nga operatori i multipleksit që ka marrë frekuencë nga KPM-ja të paraparë për transmetime radiodifuzive digjitale.

Grupi i punës ka propozuar amendament që të fshihet paragrafi 4 i nenit 11.

Komisioni e përkrahu këtë amendament.

Amendamenti 14

Neni 11, paragrafi 4, fshihet.

Pas paragrafit 4 të nenit 11, grupi i punës propozon amendament që të shtohet një paragraf i ri.

Komisioni përkrahu amendamentin me tekstin si në vijim:

Amendamenti 15

Neni 11 të shtohet një paragraf i ri si në vijim:

Të gjithë operatorët që shfrytëzojnë radio frekuenca në brezin 790 – 862 MHz, duhet të lirojnë kanalet frekuencore në shfrytëzim dhe të hapin mundësitë për shërbimet mobile brezgjëra, jo më vonë se deri në datën e caktuar, me Vendim të veçantë nga ana e KPM-së, të referuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Grupi i punës ka propozuar amendament që të ndryshohet paragrafi 3 i nenit 12, sepse teksti si në projektligj i referohet personave që paguajnë kontributet për transmetuesin publik, ndërsa siç është e njohur qytetarët nuk paguajnë për këtë transmetues publik.

Komisioni përkrahu amendamentin me tekstin si në vijim:

Amendamenti 16

Neni 12.3 ndryshohet si në vijim:

3. Në pajtim me këtë nen, përfitues të masave të tilla stimuluese janë kategoritë e rasteve sociale, të cilat janë të përcaktuara nga Ministria përkatëse për çështje sociale.

Zoti **Qela** tha se Grupi i punës ka propozuar amendament, që nenit 12 t'i shtohet një paragraf i ri, me të cilin e bën përgjegjëse Ministrinë të rregullojë përgjegjësinë për shitjen, shpërndarjen dhe përcaktimin e çmimit të pranuesve digjital dhe mjeteve tjera të nevojshme.

Komisioni pas diskutimit nuk e përkrahu këtë amendament dhe vendosi të fshihet amendamenti.

Grupi i punës ka propozuar amendament për nenin 13, me të cilin përveç korigjimeve gjuhësore është shmangur emërtimi “RTK” dhe në vend të tij është përdorur “transmetuesi publik”. Një çështje shtesë që është bërë me amendament, i jepet e drejta që transmetuesi publik të mund të përdorë multipleksin edhe për kanale tjera në konsultim me KPM-në.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që ky amendament të ketë këtë përmbajtje:

Amendamenti 17

Neni 13 ndryshohet si në vijim:

Me qëllim të transmetimit radiodifuziv digjital të sinjaleve të shërbimeve të transmetuesit publik, transmetuesit publik i jepet e drejta për një multipleks, me mbulueshmëri në tërë territorin e Republikës së Kosovës, pa kryer procedurën e thirrjes publike. Transmetuesi publik përdorë multipleksin për kanalet dhe eventalisht për kanalet tjera jokomerciale nën kushtet e miratuara nga KPM-ja.

Grupi i punës ka propozuar amendament që në nenin 14 paragrafin 4, fjala “marrjen” të zëvendësohet me fjalën “dhënien”.

Komisioni e përkrahu amendamentin e grupit të punës me tekstin si vijon:

Amendamenti 18

Neni 14 paragrafi 4, fjala “marrjen” zëvendësohet me fjalën “dhënien”.

Grupi i punës ka propozuar që neni 16 të ndryshohet. Ndryshimi ka të bëjë me rolin parësor që do të kenë KPM-ja dhe Autoriteti në ndryshimin e vendimit për ndarje të radio-frekuencave për multipleks.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që neni 16 të fshihet.

Amendamenti 19

Neni 16 fshihet.

Grupi i punës me amendament ka propozuar riformulimin e nenit 18, me të cilin ka shmangur referimin që për pagesat për shfrytëzimin e radio-frekuencave për multipleks të merren parasysh pagesat e ngjashme në shtetet e Bashkimit Evropian.

Lidhur me këtë amendament, **kryetari Muhamet Mustafa**, propozoi që teksti në fund të amendamentit “ por kjo shumë në asnjë rast nuk mund të jetë aq e lartë sa që të pengojë konkurrencën në treg” të zëvendësohet me “por kjo lartësi e shumë duhet të sigurojë konkurrencë dhe barazi në treg”.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetarit Mustafa, dhe vendosi që amendamenti të jetë me tekstin si në vijim:

Amendamenti 20

Neni 18 paragrafi 2, riformulohet si në vijim:

2. Shuma minimale e pagesave në fjalë përcaktohet më rregullore të miratuar nga KPM-ja. Gjatë përcaktimit të nivelit të pagesës dhe metodës së kryerjes së pagesës në fjalë, merren parasysh oferta dhe kërkesa për frekuencat e lëshuara në përdorim, zhvillimi i tregut në të cilin

aplikohen këto frekuenca, por kjo lartësi e shumë duhet të siguroj konkurrencë dhe barazi në treg.

Raif Qela tha se ka propozuar amendament për ndryshimin e nenit 19, me të cilin janë shmangur emërtimet fikse për televizione, si dhe është caktuar që rregulla “must carry” për transmetuesit privat me mbulim shtetëror të vlejë deri në përfundim të afatit të licencës. Me këtë amendament po ashtu është shtuar një paragraf i ri me të cilin i jepet e drejta KPM-së që ta përcaktojë renditjen numerike të kanaleve televizive të përfshira me rregullat “must carry”.

Pas diskutimeve Komisioni përkrahu këtë amendament me një ndryshim në paragrafin 2(dy) sipas amendamentit, dhe vendosi që amendamenti të jetë me tekstin si në vijim:

Amendamenti 21

Neni 19 ndryshohet si në vijim:

- 1. Operatori i multipleksit në nivel shtetëror duhet të sigurojë përfshirjen në multipleks me rregullat “must carry”, të dy programeve të transmetuesit publik në afat të pacaktuar dhe të dy kanaleve me mbulim shtetëror të licencuara nga KPM-ja për transmetim tokësor, deri në përfundim të afatit të licencës.*
- 2. Operatoret e multipleksit në nivel rajonal duhet të sigurojë përfshirjen në multipleks me rregullat “must carry”, të të gjitha kanaleve rajonale dhe lokale të licencuara nga KPM-ja për transmetim tokësor, në pajtim me politikat strategjike të KPM-së.*
- 3. Kriteret për përfshirjen sipas rregullave “must carry”, përcaktohen me një akt nënligjor të nxjerrë nga KPM-ja, jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.*
- 4. Kriteret që i referohen paragrafit 3 të këtij neni bëhen në përputhje me analizën e tregut dhe nevojat publike të Republikës së Kosovës.*
- 5. KPM-ja përcakton renditjen numerike të kanaleve televizive të licencuara, të përfshira me rregullat “must carry”, me akt nënligjor të veçantë.*

Grupi i punës ka propozuar që paragrafi 5 i nenit 22 të fshihet, sepse është në kundërshtim me parimet e hartimit të legjislacionit, pasi që dispozitat ndëshkuese duhet të vendosen me ligj e jo me akt nënligjor.

Komisioni përkrahu amendamentin që të fshihet paragrafi 5 i nenit 22.

Amendamenti 22

Neni 22 paragrafi 5 fshihet.

Grupi i punës me amendament ka propozuar që neni 25 të fshihet.

Komisioni përkrahu amendamentin që neni 25 të fshihet.

Amendamenti 23

Neni 25 fshihet.

Grupi i punës ka propozuar me amendament që afati prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve në nenin 27 të zgjatet dhe të bëhet “ 6 (gjashtë) muaj”.

Komisioni përkrahu këtë amendament.

Amendamenti 24

Neni 27, afati prej “brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve” zëvendësohet me “ 6 (gjashtë) muaj”.

Komisioni vazhdoi me shqyrtimin e propozim amendamenteve për SHTOJCËN e Projektligjit.

Grupi i punës ka propozuar amendament për nenin 1 të shtojcës, me të cilin në vend të tenderit publik për një multipleks, tenderi publik të lejohet për dy multipleks.

Komisioni përkrahu amendamentin e grupit të punës me tekstin si në vijim:

Amendamenti 25

Neni 1 i Shtojcës, ndryshohet si në vijim:

KPM-ja shpallë tender publik për lejimin e dy multipleksëve (kanalet 46 dhe 58), në pajtim me këtë ligj.

Kryesuesi i grupit të punës **z.Raif Qela**, sqaroi se lidhur me nenin 5, të Shtojcës nga anëtarët e grupit të punës ka pas pikëpamje të ndryshme rreth përbërjes dhe kryesimit të Komisionit mbikëqyrës, dhe kjo çështje ka mbetur që të vendoset në mbledhje të Komisionit.

Lidhur me përbërjen e Komisionit, duke iu referuar kërkesave të KPM-së, se ky organ duhet të jetë me pjesëmarrje më të madhe në Komisionin mbikëqyrës, **Muhamet Mustafa** propozoi që KPM-së t'i shtohet edhe një përfaqësues në Komisionin mbikëqyrës.

Pas diskutimeve, propozimi i kryetarit Muhamet Mustafa, u përkrah nga Komisioni. Po ashtu pas diskutimeve, duke u bazuar në kërkesën e KPM-së që KPM-ja të kryesojë Komisionin mbikëqyrës, Komisioni përkrahu propozimin që KPM-ja të kryesojë Komisionin mbikëqyrës, dhe propozim amendamenti përfundimtar për nenin 5 të shtojcës është si vijon:

Amendamenti 26

Neni 5, i Shtojcës, ndryshohet si në vijim:

1. Me qëllim të promovimit të transparencës dhe sigurimit të bashkërendimit të ngushtë mes autoriteteve publike, i tërë procesi do të mbikëqyret nga Komisioni Mbikëqyrës (në tekstin e mëtejme :KM-ja), në përbërjen si në vijim:

1.1 3 (tre) përfaqësues të KPM-së;

1.2 2 (dy) përfaqësues të Autoritetit;

1.3. 1 (një) përfaqësues i Ministrisë;

2. KM-ja kryesohet nga përfaqësuesi i KPM-së.

3. KM-ja do ta mbikëqyrë procedurën e tenderit publik, duke përfshirë edhe formimin e Komisionit Vlerësues (në tekstin e mëtejme KV-ja) dhe shqyrtimin e rekomandimeve të KV-së.

4. KM-ja vendimet i merr me shumicë votash, në rastet kur të pranishëm janë së paku 4 (katër) anëtarë. Secili nga anëtarët, përfshirë kryesuesin, kanë të drejtë në një votë, ndërsa për të gjitha çështjet që shtjellohen do të votohet me shumicën e votave të pjesëtarëve që votojnë. Në rast se votat janë të barabarta, vota e kryesuesit konsiderohet votë e dyfishtë dhe me të vendoset çështja në fjalë.

Gjithashtu edhe lidhur me nenin 6 të shtojcës, **z.Qela** tha se grupi i punës ka pasur pikëpamje të ndryshme, dhe kjo çështje ka mbet të vendoset në mbledhje të Komisionit.

Komisioni pas shqyrtimit të hollësishëm të nenit 6 të shtojcës dhe shqyrtimit të raportit ndërmjet Komisionit mbikëqyrës dhe Komisionit vlerësues, vendosi që neni 6 i shtojcës të ndryshohet me tekstin si në vijim:

Amendamenti 27

Neni 6 i Shtojcës, ndryshohet si në vijim:

1. KV i caktuar me vendim të KM-së, i rekomandon KM-së për miratim ofertën më të mirë në tenderin publik për multipleks.

2. KM-ja nxjerr vendim për dhënien e koncesionit për operatorin e multipleksit.

Grupi i punës me amendament ka propozuar që neni 11 i shtojcës të titullohet, sepse nuk është i titulluar.

Komisioni përkrahu amendamentin e grupit të punës për titullimin e nenit 11 të shtojcës me emërtimin si në vijim:

Amendamenti 28

Neni 11 i Shtojcës, emërtohet “Afatet për ndryshimet dhe plotësimet në dokumentacionin e tenderit”.

Grupi i punës me amendament ka propozuar që neni 13 i shtojcës të fshihet, sepse përmbajtja e nenit në fjalë nuk është relevante të rregullohet me dispozitë ligjore.

Komisioni përkrahu amendamentin e grupit të punës që neni 13 të fshihet.

Amendamenti 29

Neni 13 i Shtojcës, fshihet.

Grupi i punës me amendament ka propozuar që neni 16 i shtojcës të titullohet, sepse nuk është i titulluar.

Komisioni përkrahu amendamentin e grupit të punës për titullimin e nenit 16 të shtojcës me emërtimin si në vijim:

Amendamenti 30

Neni 16 i Shtojcës, emërtohet “Vlerësimi i ofertave”.

Grupi i punës me amendament ka propozuar që neni 19 i shtojcës të riformulohet për të shmangur konfuzionin eventual për publikimin e vendimit për dhënien e koncesionit.

Komisioni përkrahu amendamentin e grupit të punës për nenin 19 të shtojcës me tekstin si në vijim:

Amendamenti 31

Neni 19 i Shtojcës, riformulohet si në vijim:

Vendimi për dhënien e koncesionit publikohet në Gazetë Zyrtare.

Grupi i punës me amendament ka propozuar që neni 32 i shtojcës të riformulohet, dhe të krijohet mundësia e ushtrimit të ankesës në Bordin e Ankesave të KPM-së ndaj vendimit të miratuar nga KM-ja.

Komisioni gjatë shqyrtimit të këtij amendamenti, duke marrë në konsideratë se Komisioni mbikëqyrës është Komision ndërinstitucional, konsideroi se kundërshtimi ndaj vendimit të KM-së duhet të ushtrohet në gjykatën kompetente, dhe vendosi që ky amendament të jetë si në vijim:

Amendamenti 32

Neni 21 i Shtojcës, riformulohet si në vijim:

Kundër Vendimit të KM-së, pala e pakënaqur ushtron padi në Gjykatën kompetente.

Pas miratimit të amendamenteve një për një, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore;
2. Raporti t'i procedohet Komisioneve të përhershme, sipas procedurës së rregullt.

4. Themelimi i Grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizim;

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, theksoi së në Planin e Punës për vitin 2015, kemi paraparë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për standardizim. Mustafa kërkoi nga deputetët të formohet grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe propozoi që kryesues i grupit të punës të jetë deputeti Fatmir Rexhepi.

Fatmir Rexhepi tha së për shkak pushimeve vjetore që tani fillojnë, kohëzgjatja e monitorimit të këtij ligjit mund të zgjasë deri kah muaji tetor.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë

V E N D I M

1. *Formohet Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja;*
2. *Grupi i punës ka këtë përbërje: Fatmir Rexhepi , kryesues, Blerim Grainca, Raif Qela, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë;*
3. *Grupi i punës në bashkëpunim me Njësinë Koordinuese të Komisionit, të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*

5. Të ndryshme.

Çështjet vijuese

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me vizitën në Shoqatën e prodhuesve të qumështit dhe Shoqatën e qumështoreve të Kosovës, që është realizuar më 23.6.2015. Në këtë takimi përfaqësuesit e shoqatave kërkuan ndërmarrjen e masave nga institucionet, në mënyrë që të mbrohet sektori i prodhimit të qumështit. Po ashtu përfaqësuesit e shoqatave na njoftuan lidhur me vështirësitë nëpër të cilat po kalon sektori i prodhimit dhe përpunimit të qumështit. Andaj, ne si Komisioni ju kemi drejtuar më një shkresë me kërkesat e shoqatave të qumështit të gjitha institucioneve që rregullojnë këtë sektor siç janë: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Doganës. Mustafa theksoi se përgjigjet janë kthyer nga: MTI; MBZHR; AVUK. Dogana ka kthyer përgjigje se nuk jemi përgjegjës sepse jemi organ ekzekutiv dhe na ka udhëzuar të kontaktojmë me Ministrinë e Financave, por nga kjo e fundit ende nuk kemi pranuar asnjë material. Z. Mustafa, lidhur me këtë problematikë propozoi që të autorizohet organizata e shoqërisë civile “INDEP” që po e mbështet punën e Komisionit që të bëjë një hulumtim dhe analizë më theks të veçantë vendet e rajonit, si psh. në Maqedoni se si e kanë të rregulluar tregun e sektorit të qumështit, pastaj shohim se çka mund të bëjmë ne si Komision në këtë drejtim.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa